



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

Republic of Macedonia
O M B U D S M A N

LËNDA: Raporti i posaçëm për gjendjet në Qendrën e përkohshme transitore Tabanoc

Konform Ligjit për avokatin e popullit („Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 60/03 dhe 114/2009), përveç kompetencave të tjera, Avokati i populli ka kompetenca për të monitoruar se, a respektohen dhe mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar.

Avokati i popullit si Mekanizëm parandalues nacional ka mandat të përcaktuar me Protokollin fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të trajtimit brutal, jonjerëzor ose nënçmues, që i mundëson kryerjen e vizitave në vendet e privimit nga liria dhe vendet e ndalimit dhe përmes këqyrjes në kushtet materiale dhe trajtimin, t'i identifikojë rreziqet me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojit tjetër të veprimeve brutale dhe jonjerëzore dhe ndëshkuese.

Konform kompetencave, më datën 20.05.2016, Mekanizmi parandalues nacional realizoi vizitë të paparalajmëruar në Qendrën e përkohshme transitore Tabanoc, me qëllim të përcaktimit të trajtimit ndaj personave të vendosur në këtë Qendër. Njëkohësisht, duke kushtuar vëmendje të posaçme mbi shkallën e realizimit të të drejtave të këtyre personave, të garantuara me ligjet kombëtare dhe aktet ndërkombëtare, sidomos me Konventën e Zhenevës për statusin e refugjatëve të vitit 1951.

Vizita përbëheshte nga inspektimi në kushtet materiale në Qendër, takimet me personat zyrtar përgjegjës dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare, prej nga u njoftua për strukturën e tyre organizative dhe kompetencat funksionale. Në këtë rast, u zhvilluan edhe disa biseda të drejtpërdrejta me persona të vendosur në Qendër, me ç'rast Mekanizmi parandalues nacional u informua për trajtimin ndaj tyre dhe për pa-mundësinë për qasje pranë procedurës për njohjen e të drejtës për azil.

1. Struktura organizative dhe kompetencat funksionale të organeve dhe organizatave në Qendrën e përkohshme transitore Tabanoc

Në Qendrën e përkohshme transitore vazhdimisht është i pranishëm një numër i madh organesh dhe organizatash me kompetenca të ndara, të cilat përmes komunikimit dhe koordinimit të përbashkët marrin pjesë në udhëheqjen dhe menaxhimin e Qendrës.

Udhëheqja, përkatësisht menaxhimi me Qendrën e përkohshme transitore është në kompetenca të Qendrës për menaxhim me kriza (QMK). Përfaqësuesit e QMK-së në Qendrën transitore janë prezent 7 ditë në javë, më së shpeshti prej orës 8:00 deri në orën 22:00 me tre përfaqësues në ndërrim, prej të cilëve 1 (një) udhëheqës dhe 2 (dy) ndihmës, shpesh edhe përkthyes.

Ministria për punë dhe politikë sociale (MPPS), në koordinim me QMK-në, kujdeset për funksionimin e plotë të Qendrës, duke përfshirë mirëmbajtjen e higjienës dhe sigurimin e ushqimit. Përfaqësuesit e MPPS-së në terren janë prezent 24 orë, në dy ndërrime nga 12 orë. Gjithsej personeli i angazhuar në Qendër numëron 10 (dhjetë) të punësuar, prej të cilëve 2 (dy) punëtorë përgjegjës, 4 (katër) punonjës të administratës dhe 4 (katër) punonjës social, të cilët janë të sistemuar në grupe prej nga 1 (një) përgjegjës, 2 (dy) punonjës administrativ dhe 2 (dy) punonjës social në ndërrim. Për mirëmbajtjen e higjienës në Qendrën transitore Tabanoc nga ana e MPPS-së janë angazhuar 24 persona.

Ministria për punë të brendshme (MPB) është kompetente për sigurimin e siguritetit, rendit dhe disiplinës të personat dhe objektet në suaza të Qendrës së përkohshme transitore. Përfaqësues të MPB-së, gjithashtu në terren janë prezent 24 orë në dy ndërrime nga 12 orë. Numri i personelit të pranishëm në ndërrim është variabil, prej 5 (pesë) deri më 9 (nëntë) përfaqësues në ndërrim, varësisht nga nevojat.

Mbrojtja shëndetësore në Qendrën e përkohshme transitore është në organizim të Institutit për shëndet publik, Ministrisë për shëndetësi dhe Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Ekipi medicinal i pranishëm në ndërrim përbëhet nga 1 (një) doktor, 1 (një) motër dhe 1 (një) vozitës, ndërsa ndërrimi zgjatë 12 orë. Ndihma medicinale në Qendër është e arritshme 24 orë. Ushtruesit e mbrojtjes shëndetësore të angazhuar në Qendër shfrytëzohen nga dy burimet-përmes „Project hope”, projekt i njerëzve të angazhuar përmes Ministrisë për shëndetësi dhe përmes përfaqësuesve të punësuar të enteve shëndetësore, siç janë Shtëpia e shëndetit Kumanovë, Shtëpia e shëndetit Kriva Palankë, Shtëpia e shëndetit Kratovë dhe Qendra shëndetësore Likovë.

Përveç përfaqësuesve të lartpërmendur të angazhuar në terren përmes Institutit për shëndet publik dhe Ministrisë për shëndetësi, për mbrojtjen shëndetësore në Qendër është angazhuar edhe ekipi i përfaqësuesve të Kryqit të kuq, të cilët gjithashtu janë vendosur në kontejner të veçantë në Qendër, 24 orë në dy ndërrime nga 12 orë,

ndërsa ekipi medicinal në ndërrim përbëhet nga 1 (një) mjek., 1 (një) paramedik dhe 1 (një) përkthyes (i angazhuar vetëm në një ndërrim). Së këtejmi, gjithsej personeli i angazhuar nga Kryqi i Kuq numëron 2 (dy) mjek, 2 (dy) paramedikë dhe 1 (një) përkthyes.

Nga organizatat ndërkombëtare aktive në ndarjen e ndihmës në Qendrën e përkohshme transitore Tabanoc, përveç UNHCR-së (UNHCR) të pranishëm ishin edhe Internacional organisation for migration – IOM-i (IOM), UNICEF-i (UNICEF) dhe SOS Fshati i fëmijëve. Në kompetenca të IOM-it është që t'u dalin në ndihmë emigrantëve të cilët duan të kthehen në vendet e tyre, ndërsa UNICEF-i dhe SOS Fshati i fëmijëve janë përgjegjës për mirëmbajtjen e hapësirës për kujdesjen e fëmijëve. Përfaqësuesit e IOM-it kanë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) persona, ekip i mobiluar, të cilët në terren janë prezent në një ndërrim që zgjatë 12 orë dhe me nga 5 (pesë) persona në ndërrim. Ndërsa, në „hapësirën e fëmijëve” ka nga 6 (gjashtë) persona në ndërrim, përfaqësues përgjegjës për kujdesin ndaj fëmijëve, ndërkaq ka edhe 5 (pesë) udhëheqës dhe 1 (një) përkthyes. Hapësira është e hapur 24 orë dhe funksionon në tre ndërrime me nga 8 orë. Personeli në „kopshtin” është në kompetenca të SOS Fshatit të fëmijëve.

Nga sektori joqeveritar, në Qendrën e përkohshme transitore Tabanoc janë prezent përfaqësues të Shoqatës magedonase të juristëve të rinj (SHMJR) dhe Legis. Përfaqësuesit e SHMJR-së në terren janë të vendosur dhe prezent 24 orë, ndërkaq të shpërndarë në tre ndërrime dhe më së shpeshti në ndërrimin e parë dhe të dytë ka edhe nga 1 (një) jurist dhe 1 (një) përkthyes, ndërsa në ndërrimin e tretë- të natës, vetëm jurist. Ndërsa, ekipi i organizatës joqeveritare Legis është e mobiluar dhe shpesh e pranishme në terren gjatë periudhës prej orës 11.00 deri në orën 19:00 dhe e njëjta numëron 10 (dhjetë) persona të angazhuar rregullisht për ndihmë në Qendër dhe 14 (katërmëdhjetë) vullnetarë. Nga të angazhuarit në mënyrë të rregullt dhe vullnetarët, në një ndërrim / vizitë në Qendër zakonisht janë prezent nga 7 (shtatë) persona.

2. Gjendje e hasur në Qendrën e përkohshme transitore Tabanoc

Ekipi i Mekanizmit parandalues nacional duke vepruar konform Metodologjisë për parandalimin e torturës dhe llojit tjetër të trajtimit brutal, çnjerëzor ose nënçmues dhe ndëshkues, bëri inspektim në Qendrën e përkohshme transitore Tabanoc.

Kushtet materiale dhe gjendja aktuale

Qendra e përkohshme transitore Tabanoc disponon me 47 (dyzet e shtatë) kontejnerë, 36 (tridhjetë e gjashtë) module Ikea--shtëpiza, 3 (tre) tenda-rapkolë, 1 (një)

kuzhinë të ngrohtë me tendë, 1 (një) qendër distributive, 1 (një) depo qendrore-kryesore në kamp, 4 (katër) tualetë me nga 10 (dhjetë) njësi tualetesh, 2 (dy) dush kabina, 1 (një) njësi për ftohje dhe 1 (një) modul kontejneri - magazine. Këto të dhëna janë konfirmuar zyrtarisht edhe përmes inspektimit në Qendër edhe përmes Regjistrimit të dokumentuar zyrtar të të gjitha mjeteve që gjenden në Qendrën transitore Tabanoc (objekte, infrastrukturë dhe mjete teknike- materiale), në udhëheqje nga Qendra për menaxhim me kriza.

Qendra disponon me ujë të ngrohtë 24 orë në ditë, por sipas informatave të marra nuk ka ujë të pijshëm.

Qendra transitore ka kapacitete strehuese për 1.000 (një mijë) persona, ndërsa në ditën e vizitës ishte e pa mundur të merren të dhëna lidhur me numrin e saktë të personave prezent, nga arsyeja se kinse askush nga organet përgjegjëse për udhëheqje dhe menaxhim me Qendrën nuk posedojnë shënime të tilla.

Organet përgjegjëse për udhëheqjen e evidencave të tilla ndërmjet vetes e hudhin përgjegjësinë. Sipas të dhënave jozyrtare të marra nga përfaqësuesit e Ministrisë për punë të brendshme, në ditën e vizitës Qendra numëronte 207 (dyqind e shtatë) persona, prej të cilëve 129 (njëqind e njëzet e nënte) nga Siria, 74 (shtatëdhjetë e katër) nga Avganistani, 3 (tre) nga Irani dhe 1 (një) person nga Iraku.

Personat e pranishëm në Qendrën transitore numërohen vetëm gjatë shpërndarjes së ushqimit dhe në këtë mënyrë merret vesh se sa persona e kanë lëshuar Qendrën. Madje edhe numri jozyrtar ditor gjatë ditës së vizitës të cilin e morri Mekanizmi parandalues nacional nga përfaqësuesi i MPB-së është marrë në koordinim ndërmjet MPB-së dhe MPPS-së dhe është marrë si rezultat i numërimit gjatë kohës së ngrënies së mëngjesit. Edhe përkaj inspektimit të ekipit të Mekanizmit parandalues nacional dhe thirjes në mandatin e Avokatit të popullit, megjithatë qasje pranë evidencës zyrtare sa i përket numrit të personave prezent në Qendër (të kategorizuar sipas moshës, gjinisë, datës së arritjes etj.) nuk u mundësua.

Sigurimi i ushqimit

Furnizimi dhe distribuimi i ushqimit është siguruar nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, krahas periudhës së mëparshme në të cilën ushqimi ishte siguruar përmes donacioneve të sektorit joqeveritar. Menyja përbëhet nga tre vakte në ditë dhe distribuimi dhe furnizimi i ngrënies është ndarë në mënyrë proporcionale ndërmjet MPPS-së dhe Kryqit të kuq. Furnizuesi i ushqimit dhe menya janë identike me ato të Qendrës së përkohshme transitore Vinojug-Gjevgjeli.

Mekanizmi parandalues nacional morri informatë se personat e vendosur në Qendër nuk janë të kënaqur nga ushqimi, i cili me sa duket nuk tejkalon menynë ditore, por është marrë informatë se një vakt kushton 600,00 denarë dhe i njëjti sipas cilësisë dhe sasisë nuk i përgjigjet çmimit.

Aktivitetet e sektorit joqeveritar dhe të organizatave ndërkombëtare

Përmes bisedave me përfaqësuesit e sektorit joqeveritar, Mekanizmi parandalues nacional erdhi deri te njohuritë se për çdo donacion të sasisë shtesë të ushqimit, veshëmbathjes, këpucëve, produkteve higjienike dhe ngjashëm, është i domosdoshëm pëlqimi nga organet dhe organizatat kompetente për organizim dhe menaxhim me Qendrën (QMK, Ministrinë për punë dhe politikë sociale, Kryqi i Kuq i RM-së).

Shoqata maqedonase e juristëve të rinj u ndihmon personave të vendosur në Qendër, duke u siguruar ndihmë juridike dhe këshilluar për të drejtën e tyre për qasje pranë procedurës për pranimin e të drejtës për azil.

Përfaqësuesit e organizatës joqeveritare Legis me prezencën e tyre në terren në Qendrën e përkohshme transitore, ndihmojnë përmes donimit të ushqimit, veshëmbathjes, këpucëve dhe medikamenteve, gjithashtu mbështesin edhe aktivitetet sportive dhe rekreative në Qendër. Përfaqësuesit përgjegjës të organizatës Legis kanë vërejtje sa i përket mënyrës së shpërndarjes së donacioneve të cilat i ndajnë ata, përkatësisht dyshojnë se ushqimi dhe veshëmbathja e donuar keqpërdoret dhe nuk dërgohet pranë personave për të cilët është dedikuar. Por, kohëve të fundit ky problem zgjidhet në mënyrë që organizatat-donatëre dhe organet përgjegjëse sëbashku i distribuojnë mjetet për t'u ndihmuar refugjatëve.

Në Qendrën transitore në organizim të UNICEF-it dhe SOS Fshatit të fëmijëve ekziston edhe një hapësirë për përkujdesjen e fëmijëve të moshës deri më 10 vjet. Për numrin e fëmijëve të cilët e shfrytëzojnë këtë „hapësirë për fëmijë" udhëhiqen Raporte, sipas të cilëve në ditën e vizitës në „kopshtin" ka pasur 119 fëmijë. Në këtë hapësirë për përkujdesjen e fëmijëve organizohen aktivitete për mbështetje psiko-sociale, aktivitete edukative dhe rekreuese, mësim i gjuhëve dhe ngjashëm. Hapësira për përkujdesjen e fëmijëve të moshës më të vogël është e hapur/dhe në dispozicion gjatë 24 orëve.

Mbrojtja shëndetësore

Instituti për shëndetësi publike, Ministria për shëndetësi dhe Kryqi i kuq i RM-së janë përgjegjës për mbrojtjen shëndetësore në Qendër. Në aspekt të mbrojtjes shëndetësore u konstatua se Ambulanca është furnizuar me medikamente të nevojshme dhe pajisje, në mënyrë të rregullt udhëhiqet evidenca për personat të cilët kanë kërkuar ndihmë të rregullt dhe urgjente medicinale. Personeli mjeksor aktiv në terren shprehi nevojë për sasi më të madhe të ujit, të domosdoshme për të mundësuar ndihmën shëndetësore pa ndërprerje, si dhe frigorifer si pjesë e pajisjes mjeksore për ruajtjen e medikamenteve të caktuara.

Siç u përmend më lart, ekipi medicinal në terren është i pranishëm 24 orë, ndërkaq kjo praktikohet prej datës 08 mars të këtij viti për shkak të rritjes së nevojave për ndihmë medicinale, si rezultat i gjendjeve aktuale të shkaktuara nga fluksi i madh i refugjatëve.

Mekanizmi parandalues nacional hasi në një bashkëpunim të shkëlqyer me ekipet medicinale në Qendër dhe ishte mundësuar qasja e pandërprerë dhe e plotë pranë të gjitha materialeve dhe informatave të nevojshme për inspektimin e gjendjes faktike, duke u nisur nga kontrolli mbi kushtet fizike në të cilat eksiston Ambulanca, pajisjen e siguruar dhe medikamentet, deri te inspektimi në evidencën e të gjithë personave ndaj të cilëve është intervenuar me çfarë do ndihmë medicinale. Inspektime të tilla në evidencën janë kryer edhe në Ambulancën e përfaqësuesve të Shëndetit publik dhe në evidencën e përfaqësuesve të Kryqit të kuq.

Nga evidencat dhe bisedat Mekanizmi parandalues nacional konstatoi ser për momentin nuk ka epidemi dhe sëmundje problematike, por kohët e fundit ka pasur raste me zhgjedhë, morra dhe varicelë. Për gjendjet e këtilla janë ndërmarrë masat e nevojshme dhe të njëjtat janë sanuar. Eksiston edhe një kontejner i veçantë/shtëpizë për inkubacion dhe sipas të thënave nga personat medicinal, janë plotësuar kushtet për t'u përballur me epidemi të tilla. Sipas situatës në ditën e vizitës, në Qendër kishte 1 (një) person i sëmurë nga diabeti i cili ishte nën trajtim përkatës medicinal, si dhe trajtim përkatës me ushqim. Deri më tani ka pasur disa raste në baza të ndryshme për ndihmë urgjente medicinale edhe jashtë Qendrës, e njëjta është ndërmarrë, ndërkaq kjo vën në pah kushtet e kënaqshme për udhëzimin e pacientëve jashtë Qendrës, te specialisti ose për ndihmë të veçantë urgjente medicinale. Megjithatë, ekipet medicinale disponojnë me 1 (një) veturë përkatëse medicinale në ndërrim.

Përveç kontrolleve të rëndomta dhe trajtimit, në Qendër ndërmerren aksione edhe më të mëdha higjienike dhe mbrojtëse-medicinale. Gjatë periudhës prej 19 deri më 24 prill të këtij viti kur në Qendër kanë qenë të vendosur mbi 600 (gjashtëqind) persona, është zbatuar vaksinimi i saktë i 604 (gjashtëqind e katër) personave me vaksinën polio. Në Qendër rregullisht bëhen analiza të ujit dhe inspektime epidemiologjike, ndërsa dy herë në ditë bëhet edhe desinfeksioni, që përfshin edhe deratizimin dhe desinseksionin.

Qasje pranë të drejtës për azil

Nga bisedat me përfaqësuesit e Shoqatës maqedonase të juristëve të rinj, si dhe nga bisedat e realizuara në mënyrë të drejtpërdrejtë me tre persona nga Siria të cilët shprehën qëllim të qartë për parashtrimin e kërkesës për njohjen e të drejtës për azil, Mekanizmi parandalues nacional mori njohuri se këtyre personave nuk u është mundësuar të paraqesin kërkesa për njohjen e të drejtës për azil, me arsye të ndryshme (në kuptim, „të mendojnë përsëri dhe të rishqyrtojnë se, a duan me të vërtetë të paraqesin kërkesë për njohjen e të drejtës për azil“, si dhe pohimet e shpeshta të zyrtarëve policor se duhet të konsultohen me personat udhëheqës zyrtarë në lidhje me mundësimin për paraqitjen e kërkesës për realizimin e të drejtës për azil).

Avokati i popullit-Mekanizmi parandalues nacional konstatoi se numri i personave të përkujdesur në Qendrën e përkohshme transitore vazhdimisht po zvogëlohet, kështu që krahas numrit fillestar prej mbi 1.200 (një mijë e dyqind) persona të cilët ishin të pranishëm në muajin janar, gjatë vizitës është konstatuar numri prej vetëm 207 (dyqind e shtatë) persona. Nga informatat e marra del se asnjë organ nuk mbanë evidencë (ose qëllimisht nuk i dërgohen të dhëna Avokatit të popullit), sa persona dhe në çfarë mënyre e lëshojnë Qendrën, ndërkaq nuk janë unik edhe sa i përket çështjes se, a është Qendra e përkohshme transitore e karakterit të mbyllur apo e karakterit të hapur. Praktika e inkorporuar flet se personat e vendosur në Qendër vazhdimisht e lëshojnë hapësirën e rrethuar pa kërkuar ndonjë leje të posaçme, ndërkaq për këtë organet kompetente nuk mbajnë kurrfarë evidencë zyrtare.

Mekanizmi parandalues nacional, gjithashtu u njoftua se gjatë periudhës prej 15 deri më 29 prill numri i emigrantëve/refugjatëve ka qenë mjaft i zvogëluar kështu që nga personat e përkujdesur 600-700 (gjashtëqind-shtatëqind) emigrantëve/refugjatëve për momentin në Qendër qëndrojnë rreth 200 (dyqind) persona (për çka nuk ekziston evidencë zyrtare). Nga informatat e marra nga organizatat joqeveritare, Mekanizmi parandalues nacional u njoftua se pikërisht në atë periudhë nga ana e Qendrës për menaxhim me kriza është sjellur Konkluzioni, me të cilin është kufizuar prania e disa organizatave të sektorit joqeveritar në orët e mbrëmjes.

KONSTATIME

1. Është i dobët bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet organeve dhe organizatave kompetente të cilat menaxhojnë me udhëheqjen dhe organizimin e Qendrës.
2. Mekanizmi parandalues nacional u pengua nga përfaqësuesit e Ministrisë për punë dhe politikë sociale, Ministria për punë të brendshme dhe Qendra për menaxhim me kriza për kryerjen e inspektimit të drejtpërdrejtë në listën për evidencë të personave të pranishëm në Qendër.

3. Ministria për punë të brendshme i pengon refugjatët/emigrantët në qëllimin për të paraqitur kërkesë për realizimin e të drejtës për azil. Në terren nuk ka përfaqësues të Sektorit për azil të cilët do t'i informonin refugjatët/emigrantët për qasjen pranë kësaj të drejte.
4. Askush nuk udhëheq evidencë zyrtare për numrin e personave të arritur dhe për personat të cilët e lëshojnë Qendrën (të kategorizuar sipas moshës, gjinisë, datës së arritjes dhe ngjashëm), dhe askush nga organet kompetente nuk evidenton personat të cilët për çdo ditë kohë pas kohe dalin dhe hyjnë në Qendër.
5. Mungon pajisja përkatëse medicinale, përkatësisht ujë për përdorim medicinal dhe frigorifer për ruajtjen e medikamenteve në ambulancën e mobilizuar të Ministrisë për shëndetësi.
6. Ekzistojnë lëshime në lidhje me shpërndarjen dhe distribuimin e sendeve të donuara (veshëmbathje, ushqim, ndihmë medicinale dhe ngjashëm).

REKOMANDIME

1. Është i domosdoshëm bashkëpunimi dhe koordinimi më i mirë dhe më efektiv ndërmjet organeve të cilat menaxhojnë dhe udhëheqin Qendrën e përkohshme transitore.
2. Bashkëpunim më i madh i përfaqësuesve në terren të organeve dhe organizatave kompetente dhe t'i mundësohet Mekanizmit parandalues nacional të kryejë inspektimin pa pengesa në listën për evidencë të personave të pranishëm në Qendër.
3. Ministria për punë të brendshme të sigurojë praninë e përfaqësuesve të Sektorit për azil në Qendrën e përkohshme transitore me qëllim të informimit për të drejtën e paraqitjes së kërkesës për pranimin e të drejtës për azil dhe të mundësohet qasje papengesa pranë procedurës.
4. Të mbahet evidenca zyrtare dhe e përsheptuar për numrin e personave të arritur dhe personave të cilët përçdoherë ose kohë pas kohe e lëshojnë Qendrën (të kategorizuar sipas moshës, gjinisë, datës së arritjes dhe ngjashëm).
5. Ministria për shëndetësi të sigurojë pajisje të domosdoshme medicinale dhe frigorifer për ruajtjen e medikamenteve, ndërsa sa i përket infrastrukturës në Qendrën e përkohshme transitore kompetentët të zbatojnë dhe mundësojnë qasje të vazhdueshme pranë ujit për nevoja medicinale.
6. Organet kompetente të sigurojnë transparencë më të madhe sa i përket distribuimit të mjeteve të donuara.